

Sipas shkrimit të medieeve ndërkombëtare, të cilat i referohen burimeve të Agjencisë Kozmike Amerikane NASA, nuk është larg dita kur Dielli do të lind nga Perëndimi në vend se nga Lindja. “Daily Mail” dhe „Huffington post“ raportuan për të dhënat serioze dhe faktike shkencore që ka NASA dhe Agjencia Kozmike Evropiane për kthesën e madhe të llojit të vet që do të pësojë poli magnetik e që për pasojë do të ketë lindjen e Diellit nga ana Perëndimore. Revista amerikane “Live Science” thekson se poli magnetik i Tokës nuk është aq i fuqishëm sa ka qenë në të kaluarën dhe është dobësuar për dhjetë herë më shumë, kurse ky dobësim ka marrë përmasa më të mëdha këto gjashtë muajt e fundit. Faktin e hidhur të ndryshimit që ka pësuar poli magnetik e ka konfirmuar edhe Agjencia Kozmike Evropiane, e cila po ashtu ka vërtetuar se kjo do të thotë se Dielli do të lind nga Perëndimi. Siç dihet lindja e Diellit nga Perëndimi është përmendur në hadithin e Muhamedit alejhiselam si shenjë e madhe e Ditës së Kijametit. Ndërsa Allahu në Kuran thotë: “Hëna është çarë dhe Kijameti është afruar” (El Kamer 1), “Njerëzve u është afruar Kijameti, por ata të hutuar në pakujdesi nuk përgatiten fare për të”, (El Enbija 1) etj.

Burimi: [NASA: “KIJAMETI NUK ËSHTË LARG – DIELLI DO TË LIND NGA PERËNDIMI”](#)